



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 97
Prishtinë, më 2.4.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Visar Korenica, Yllëza Hoti, Hajdar Beqa, Albana Bytyçi.

Munguan: Bekim Arifi, Rashit Qalaj, Halil Thaçi dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit tjerë: Osman Vishaj, Avni Sahiti, Fidane Gjikolli dhe Agron Ibishi nga KRPP; Myrvete Gashi, Samir Zymeri dhe Driada Thaçi nga ZKA.

Mbledhjen e kryesuan: Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit dhe Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.3.2024;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të teknologjisë së informacionit “Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi”;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 12.3.2024

Procesverbali u miratuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të teknologjisë së informacionit “Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi”

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Të nderuar kolegë deputetë! Për ta shqyrtuar këtë pikë, ne kemi ftuar kryetarin e KRPP-së, z. Osman Vishaj, të cilin sot e kemi prezent. Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer këtë auditim, që të vlerësohet nëse KRPP-ja ka menaxhuar me efektivitet operacionet e TI-së, që të sigurohet se sistemi elektronik “E-Prokurimi” mbështet në vazhdimësi në procesin e prokurimit publik, si dhe ruan integritetin e tij. Ky raport ka rezultuar në disa gjetje, andaj duke u bazuar në to, ZKA ka dhënë 13 rekomandime për Komisionin Rregullator të Prokurimit Publik, në bashkëpunim edhe me institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës. Për t’i shpalosur gjetjet në këtë raport, si Komision, kemi caktuar deputetin Hajdar Beqa, andaj edhe ia kaloj fjalën.

Hajdar Beqa: Do t’i paraqes gjetjet që i ka identifikuar ZKA, gjatë këtij auditimi, të cilat kanë për qëllim që edhe KRPP-së dhe përdoruesve të tjerë të këtij sistemi, t’iu ndihmojnë në qasjen dhe menaxhimin e shërbimeve të sistemit. Gjetja e parë është se KRPP-ja nuk ka strukturë të plotë organizative dhe ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësive në TI. Departamenti i Prokurimit elektronik nuk i ka të plotësuar të gjitha pozitat e parapara dhe të aprovuara me ligjin për buxhet, si dhe sipas rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendit të punës, me ç’ rast pozita e drejtorit të departamentit është me zëvendësues, ndërsa dy pozitat e udhëheqësve nuk janë të plotësuar fare. Andaj, mungesa e burimeve të mjaftueshme, bëjnë që KRPP-ja të rrezikojë të dështojë që të jetë transparente dhe llogaridhënëse. Gjithashtu rrezikon në mosarritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe përmbushjen e nevojave për funksionimin adekuat të sistemit “E-Prokurimi”.

Gjetje tjetër është se KRPP-ja nuk ka krijuar një strategji për të siguruar vazhdimësinë e operimeve, pasi që mungesa e zhvillimit të kapaciteteve të brendshme dhe kryerja e detyrave të rëndësishme/jetike për funksionin e sistemit me kontraktorë të jashtëm, ka rrezikuar që KRPP-ja të krijojë varësi ndaj palëve të treta. Gjetja tjetër është se KRPP-ja nuk është mjaftueshëm efikase ndaj menaxhimit të problemeve në sistem. Sipas procedurës, rastet e incidenteve për sigurinë e informacionit duhet të raportohen te zyrtari i sigurisë së informacionit. Mirëpo, aktualisht, në këtë institucion nuk ka zyrtar që është i ngarkuar me këto detyra. Një gjetje tjetër është se KRPP-ja nuk ka proceduar për menaxhimin e ndryshimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit. KRPP-ja ka të hartuar, por të paaprovuar një draft-dokument, që nga viti 2018. Edhe pse kjo politikë nuk është aprovuar, proceset e ndjekura nga KRPP-ja janë bazuar në këtë politikë, lidhur me ndryshimet që ka bërë në sistemet e saj. Mirëpo, ky dokument nuk e ka të përfshirë procesin për ndryshimet emergjente. Andaj, kjo rrit rrezikun e devijimit nga një plan i përcaktuar, duke lejuar ndryshime të paautorizuara, të patestuara dhe të pamjaftueshme, që mund të ketë ndikim në operacionet e sistemit ose të mos identifikojnë gabimet gjatë fazës së testimit. Po ashtu, ZKA si gjetje ka identifikuar se edhe kontrollet hyrëse në aplikacion nuk janë të mjaftueshme për parandalimin e procedimit të të dhënave të pasakta.

Gjetje tjetër është se E-prokurimi nuk ka ndërlidhje me sistemet e tjera të qeverisë. Sistemi e-prokurimi, deri më tani, shkëmben të dhëna vetëm me ATK-në. Mirëpo, e-prokurimi nuk i ka paraparë ndërlidhjet e nevojshme, ashtu që të merren informatat të tjera në ATK p.sh., siç është vërtetimi mbi borxhet tatimore, që është kriter për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit. Ky

sistem nuk ka ndërlidhje me sistemin e ARC-së, po ashtu as me SIMFK. Ndërlidhja mes sistemeve bazë të IRK-ve, shmang pasaktësitë dhe keqpërdorimet e mundshme të proceseve të prokurimit. Gjetje tjetër nga ZKA është se ka mangësi në menaxhimin e llogarive në sistemin elektronik të prokurimit publik. Llogaritë e përdoruesve nuk janë rishikuar nga autoritetet kontraktuese, që e kanë obligim mirëmbajtjen e përdoruesve të tyre dhe as nga KRPP-ja, si pronare e kësaj platforme. Po ashtu, sipas ZKA-së, nuk është efikas as procesi i hapjes së llogarive të përdoruesve në e-prokurim. Pra, nga lista e përdoruesve, për autoritetet kontraktuese nga institucionet publike, janë identifikuar së paku 4,600 përdorues, që për hapjen e llogarive në këtë sistem, kanë shfrytëzuar llogari private/jozyrtare. ZKA, po ashtu ka gjetur se nuk ka monitorim të aktiviteteve të përdoruesve. Pra, rishikimi i gjurmëve të aktiviteteve në sistem nuk bëhet në baza të rregullta kohore. Mungesa e monitorimit dhe trajtimit të ngjarjeve të aktiviteteve, në periudha të caktuara kohore, paraqet rrezik të mosidentifikimit të gabimeve dhe keqpërdorimeve me kohë apo mosidentifikimin fare të tyre. Të nderuar, kaq kisha sa i përket gjetjeve, ndërkohë do të kycem për pyetje.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Sipas rregullave që kemi si Komision, fjalën ia kaloj drejtorit, z. Osman Vishaj, pastaj e hapim diskutimin për pyetjet parlamentare.

Osman Vishaj, KRPP: Unë do të flas në vija të trasha në lidhje me planin e veprimit, ndërsa për pjesët teknike e kam edhe stafin me vete. Unë e falënderoj ZKA-në për këtë auditim. Ata e kanë cekur që nuk ka gjetje materiale, megjithëkëtë, ne nuk duhet të kënaqemi me këto të arritura. Siç thuhet edhe në raport, zhvillimi i sistemit të e-prokurimit është një nga prioritetet e teknologjisë, sepse ky sistem është një element kyç, për transparencën dhe efektivitetin gjatë zbatimit të ligjit të prokurimit. Ky sistem ka filluar gradualisht të funksionojë nga shtatori i 2016, duke filluar nga niveli qendror dhe u shpërnda ndër vite, te niveli komunal dhe duke u avancuar nga viti në vit. Tani përdorimi i këtij sistemi, që nga dorëzimi i ofertave dhe ankesave dhe të gjitha procedurave tani janë të detyrueshme të kryhen përmes sistemit të e-prokurimit. Ky sistem, përveç efikasitetit, ka rritur edhe transparencën. Pra, tani çdo aktivitet i prokurimit është transparent në çfarëdo faze që të jetë aktiviteti. Ndërsa, sa i përket pozitave të zyrarëve, ne kemi miratuar strukturën e re, por jemi duke u përballur me staf. Vetëm në kohën sa ka qenë ZKA në këtë auditim te ne, 4 zyrarë nga departamenti i IT-së janë larguar, andaj kjo është duke na shkaktuar telashe të mëdha.

Hajdar Beqa: Siç e ceka edhe më herët, ky raport është i mirë, por ka disa gjetje teknike, të cilat e përmirësojnë sistemin. Por, unë kam një pyetje. Kohëve të fundit janë rritur kontratat njëburimore. Desha ta di, cili është ndikimi i juaj, sepse ju keni rol këshillues dhe sa merren parasysht këshillat e juaja nga ana e institucioneve?

Osman Vishaj, KRPP: KRPP ka rol këshillëdhënës. Mund të monitorojë procedurat e hapura dhe procedurat e negociuara. Mund të japë opinion për të gjitha procedurat. Autoriteti kontraktues mund ta marrë opinionin, por nuk është i obliguar ta marrë.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit, parashtrori dy pyetje, njëra për ZKA-në. Në faqen 8 të raportit është e paraqitur vlera e kontratave publike të nënshkruara gjatë viteve 2018- 2022. Vlera e kontratave në vitin 2018 është 631 milionë, në vitin 2019, është 781 milionë, ndërkohë pastaj kemi rënie. Kjo më duket kotradiktore, duke marrë parasysht që kemi rritje të buxhetit, deri në vitin 2023, është rritur buxheti rreth 1 miliard. Përderisa në vitin 2018 ka qenë nën 2 miliardë, ndërsa vlera e kontratave publike ka qenë 631 milionë, ndërsa në vitin 2022, kur buxheti i

shpenzuar është 2 miliardë e 625 milionë, ndërsa të shpenzuara përmes prokurimit publik i kemi vetëm 551 milionë. Nëse mund të tregoni, si ka mundësi kjo, a po shpenzohet buxheti në mënyra tjera, jo përmes prokurimit? Ndërsa, për KRPP-në kam dy pyetje: z. Vishaj, thatë se të gjitha autoritetet janë të obliguara që të gjitha dokumentet, gjatë një aktiviteti të prokurimit, t'i dorëzojnë, t'i paraqesin në e-prokurim. Derisa në paragrafin 2 të faqes 8 të raportit, thuhet se janë nënshkruar 10 290 kontrata, te tabela në faqen 9, janë vetëm 9042 kontrata. A po i bie kjo që 1248 kontrata nuk kanë shkuar përmes sistemit të e-prokurimit dhe a është kjo në rregull? Ndërsa, pyetja tjetër është sa i përket rekomandimeve. Sa e di unë, ju jepni rekomandime vetëm kur këtë ua kërkon autoriteti kontraktues. Nëse ka procedurë të negociuar, si e dini ju, a ka raste kur një autoritet kontraktues nuk e njofton fare KRPP-në? Po ashtu nuk më duket fare në rregull, nëse ju i jepni rekomandime një autoriteti kontraktues dhe ata nuk i marrin parasysh, sepse në fushën e prokurimit, ju jeni më të specializuar se secila organizatë buxhetore.

Osman Vishaj, KRPP: Po e theksoj që çdo procedurë e prokurimit, zhvillohet përmes sistemit të e-prokurimit. Nuk ka asnjë procedurë që nuk publikohet në ueb faqen e-prokurimi. Po ashtu, te procedura e negociuar, çdo procedurë publikohet në ueb faqen e sistemit e-prokurimi. Fillimin e këtyre procedurave e shohim vetëm ne dhe jo operatorët ekonomikë. Mirëpo, tani e kemi bërë obliguese, që njoftimin për dhënie të kontratës ta shohin të gjitha palët e interesit.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Për sqarim, ky njoftim bëhet pasi të nënshkruhet kontrata?

Osman Vishaj, KRPP: Jo, bëhet menjëherë pasi të shpallet fituesi. Kjo bëhet për ta dhënë mundësinë për ankesa, sepse në të kaluarën nuk ka pasur mundësi për ankesë.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Kush ankohet tani, pasi është procedurë e negociuar?

Osman Vishaj, KRPP: Ankohet pala që ka interes. Shembull, te rastet e sigurimit fizik, është ftuar vetëm një operator. Operatori që ka licencë dhe i plotëson kriteret, mund të ankohet për mosdhënien e mundësisë për të negociuar.

Mirlinda Tishukaj- Sadiku: Cili është efekti i kësaj ankese?

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Palët, të cilat ankohen, paguajnë një fije administrative, që duhet paguar, andaj nuk e di a ka ndonjë kompani interes për ankesë, cili është efekti?

Osman Vishaj, KRPP: Po, ka raste, sepse kemi edhe kontrata të ndërprera nga OSHP-ja, për arsye të tilla.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Te KEK-u, para 2 a 3 ditëve, janë nënshkruar kontrata, njëra për transport të punëtorëve, tjetra për sigurim fizik, kam hyrë, i kam parë. Janë nënshkruar kontrata, Agron Ibishi, me të njëjtin operator, i cili deri më tani ka pasur 13 kontrata. Vlera e kontratës është 411 mijë euro, për muajin prill dhe maj. Andaj, të shkojë dikush në OSHP për t'u ankuar e t'i paguajë 500 euro, është e pakuptimtë.

Agron Ibishi, KRPP: Dua ta shpjegoj diferencën që e ceku kryetarja. Kjo ndodh për shkak se një aktivitet i prokurimit mund të zhvillohet në llote. Llogaritet një aktivitet, por mund të përfundojë me 10 kontrata të nënshkruara. Po ashtu, deri në gusht të vitit 2022, vlerat minimale janë zhvilluar jashtë sistemit. Kjo është ajo që ka ndikuar.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Sa i përket rënies së buxhetit të shpenzuar në krahasim me buxhetin e tërësishëm, kam kërkuar interpretim nga ZKA-ja.

Myrvete Gashi, ZKA: Sa i përket kësaj pyetjeje, kjo nuk ka qenë temë trajtimi në këtë auditim, për shkak se tek auditimi i IT-së, është një fokus i veçantë, andaj edhe ne nuk shkojmë përtej objektivës së auditimit. Mirëpo, te auditimet e mëhershme që i kemi bërë te prokurimet, një nga shkaqet, te periudha 2020-2021, ka qenë edhe pandemia. E them një nga shkaqet, sepse ka pasur edhe shkaqe të tjera. Por, nëse kërkohet një përmbledhje e shkaqeve, mund ta nxjerrim edhe nga auditimet e tjera, sepse një analizë të tillë nuk e kemi bërë në këtë auditim.

Mirlinda Tishukaj- Sadiku: Nga ky raport kemi parë se nuk janë të ndërlidhura sistemet. E dyta, është parë se janë 9100 përdorues që nuk janë kyçur fare në platformë. 2670 përdorues nuk kanë ndryshuar asnjëherë fjalëkalimin, gjë që është obliguese. Pra, 4100 llogari, kanë informata të pasakta për mbajtësit e tyre, si dhe 1667 persona e kishin përdor llogarinë së paku një herë. Sa keni arritur nga lista e përdoruesve të evitoni këtë problematikë? Sepse, kemi përdorues që e kanë përdor edhe llogarinë private. Pasi që ka hyrë në fuqi Rregullorja 001, neni 3 i së cilës e saktëson se cilat janë format për t'i evituar këto. Sa keni mundur ta zbatoni këtë rregullore? Edhe pse OSHP-ja, në raport vjetor ka thënë se kanë pasur vështirësi në përmbushjen e misionit të tyre, sepse nuk ka pasur një rregullore të harmonizuar me ndryshimet e bëra tek e-prokurimi. Çështja tjetër është se KRPP-ja është institucion këshillues. Në një analizë që e kam parë nga një OJQ, rezulton se në dy komuna që janë marrë mostër, në hartimin dhe planifikimin e investimeve kapitale, ka tejkalime dhe nuk ka fonde të mjaftueshme. Sa keni mundur të ndikoni në këtë aspekt? Sepse, mandej po krijohen edhe borxhe. Pyetja e fundit është, a keni ndërlidhje me MINT? Sepse, aty i kemi bizneset e regjistruara në ARBK, sepse kemi shumë operatorë ekonomikë të papërgjegjshëm, të cilët edhe mund të jenë në listën e zezë. Pra, sa keni ndërlidhje që të mund të jepni këshilla, shembull që x operatori s'e ka kryer punën si duhet?

Osman Vishaj, KRPP: Sa i përket komunave, ndërlidhja me Thesarin do ta evitojë këtë problem në masë të madhe, që mos të fillojnë procedurat e prokurimit, pa mjete financiare.

Mirlinda Tishukaj- Sadiku: A ka të bëjë kjo me atë që e ka prezantuar ministri Hekuran Murati, që quhet 'invoice tracking'?

Agron Ibishi, KRPP: Ndërlidhja e sistemeve nuk ka të bëjë vetëm me 'invoice tracking', por ka të bëjë edhe me disponueshmërinë e mjeteve dhe planifikimin buxhetor. Fillimisht, jemi të ndërlidhur vetëm me ATK-në, fillimisht, sepse për t'u ndërlidhur edhe me ARRBK-në dhe regjistrat tjerë, atëherë duhet të jenë të disponueshëm ata regjistra, mos të jenë të ndërlidhur vetëm

me e-prokurimin. Mirëpo, deri tani s'ka pasur mundësi, për arsye se sistemet tjera kanë qenë jo të mundshme që të ndërlihen. Andaj, tani ndërlihdja me sistemet tjera është në proces. Sa i përket menaxhimit të përdoruesve, sistemi e-prokurimi, nuk përdoret vetëm nga autoritetet kontraktuese, por edhe nga operatorët ekonomikë, si vendorë ashtu edhe të jashtëm. Kështu që, është vështirë t'i kontrollojmë të gjitha llogaritë, sepse ka llogari që ne nuk e administrojmë. Përdoruesit e sistemit regjistrohen me të dhënat e operatorit ekonomik.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Po ndërlihdem këtu me një pyetje. Unë që hyj për t'i parë të dhënat, që nuk jam as autoritet kontraktues, as operator ekonomik, po që hyj t'i shoh kontratat, si cilësohem, sepse nuk jam si këta përdorues?

Agron Ibishi, KRPP: Ju jeni persona fizikë, sepse edhe jeni të regjistruar si persona fizikë. Pra, mund t'i shohësh kontratat, të shkarkoni dokumente, por nuk ke funksionalitete tjera, për të dorëzuar ofertë apo për të bërë ankesë. Menaxhimi i përdoruesve është përgjegjësi e autoriteteve kontraktuese. Ne nuk mund të fshijmë përdorues apo të ndryshojmë të dhëna të përdoruesve, pra është kompetencë e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë. Një gjë që është cekur edhe në raport, për ndryshimet teknike dhe ruajtjen, kjo e gjitha ka të bëjë me zyrtarin për sigurinë dhe ruajtjen e informacionit, andaj derisa nuk e kemi këtë zyrtar, atëherë disa nga mangësitë edhe janë evidente, siç janë cekur edhe në raport. Një çështje tjetër që pyeti kryetarja, për diferencën mes viteve, përveç pandemisë, siç u cek, një ndër faktorët është edhe mosfunksionimi i Bordit të OSHPS-së, sepse shumë kontrata kanë mbetur në rishqyrtim në OSHP dhe nuk kanë pasur mundësi të zbatohen.

Mirlinda Tishukaj- Sadiku: Siç e dimë, teknologjia çdo ditë po avancon. Por, ZKA ka konkluduar se KRPP nuk ka një strategji e as kapacitete të brendshme, për të vazhduar me operacione të sistemit të e-prokurimit, për periudha afatgjate. Si KRPP, keni bërë përpjekje për një strategji, por kjo ka varësi edhe nga palët e treta. Sa keni arritur ta adresoni këtë çështje, a është çështje që ka kosto buxhetore, sepse teknologjia po avancon?

Agron Ibishi, KRPP: Mungesa e strategjisë, për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të sistemit të prokurimit publik, ka të bëjë me mungesën e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore, ekspertëve me eksperiencë të veçantë, në fushën e IT-së. Kemi bërë përpjekje, disa herë, që të lirohemi nga varësia e kontraktorëve të jashtëm, por nuk kemi arritur asnjëherë të pavarsohemi, sepse ne nuk kemi mundur të angazhojmë as staf të brendshëm. Staf i brendshëm është esencial, që të jesh i gatshëm të mbështesësh operimin e vazhdueshëm të sistemit.

Fidane Gjokolli, KRPP: Desha të ndërlihdem, që të mos i mbesim borxh deputetes, për ndërlihdjen e sistemit me ARBK-në. Jemi në përpjekje, bashkë me partnerin GIZ, që ta arrijmë këtë objektiv. Ne organizojmë takime të rregullta me ZKA-në, Autoritetin e Konkurrencës dhe Policinë e Kosovës, të cilët kanë qasje në sistem, për çfarëdo që të jetë e nevojshme.

Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit: Po e shoh që nuk kemi pyetje tjera prej deputetëve. Atëherë, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe të gjitha përgjigjet që i ofruat për Komisionin. Ne, si Komision vazhdojmë takimin. Duhet të vendosim për adresimin e këtij raporti. Fjalën ia kaloj deputetit raportues.

Hajdar Beqa: Unë mendoj se janë të gjeturat teknike, që nuk janë në vullnetin e tyre, andaj nëse nuk ka propozime tjera për t'i adresuar në seancë, pajtohem.

Albana Bytyçi, tha se nuk e konsideron të nevojshme të adresohet për në seancë.

Përfundim

KMFP, me pajtueshmërinë e të gjithë deputetëve prezentë, u pajtuan që raporti i auditimit të teknologjisë së informacionit “Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi”, të mos adresohet për në seancë.

4. Të ndryshme

Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit: Në këtë pikë, Komisioni do të duhej të vendosë, nëse raporti i auditimit të performancës “Efektiviteti i programit për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike”, a do të adresohet për në seancë plenare, bashkë me rekomandimet e propozuara nga Komisioni. Por, pasi kryetarja e Komisionit ka qenë raportuese dhe iu desh të shkonte, këtë e shtyjmë për mbledhjen e radhës. Mbledhja e radhës do të mbahet më 16 prill, për shkak se e marta e ardhshme, data 9 dhe data 10, janë ditë pushimi. Me kaq mbyllet takimi për sot.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit